

Rryma elektrike

Pyetja 1

Në një pjesë të një qarku elektrik të përbërë nga dy rezistenca të barabarta të lidhura në seri, kalon një rrymë 7mA, kur diferenca e potencialit në skajet e tij është 14V. Sa është vlera e secilës rezistencë?

- A) 1Ω
- B) 10Ω
- C) 100Ω
- D) 1000Ω

Pyetja 2

Nëse duam të dyfishojmë fuqinë e një sobe elektrike, duke mos ndryshuar diferencën potenciale, na nevojitet të ndryshojmë rezistencën R me një rezistencë të barabartë me:

- A) $R/2$
- B) $R/3$
- C) $R/4$
- D) $2R$

Pyetja 3

Dy rezistenca të barabarta 500Ω janë të lidhura në paralel, dhe të dyja bashkë janë lidhur në seri me një rezistencë me vlerë $0.25k\Omega$. Rezistenca e njëvlershme është:

- A) 250Ω
- B) 500Ω
- C) 750Ω
- D) 1000Ω

Pyetja 4

Një rezistencë e cila përshkohet nga rryma me intensitet I, e ka fuqinë P. Për cilën nga çiftet e vlerave të mëposhtme, tensioni në skajet e rezistencës ka vlerë minimale?

- A) $P=2W$ $I=1A$
- B) $P=8W$ $I=2A$
- C) $P=18W$ $I=3A$
- D) $P=32W$ $I=4A$

Pyetja 5

Në një pjesë qarku të përbërë nga dy rezistenca të barabarta të lidhura në paralel, kalon rryma 3A kur në skajet e tij diferenca e potencialit ka vlerë 12V. Vlera e secilës nga rezistencat është:

- A) 1Ω
- B) 2Ω
- C) 4Ω
- D) 8Ω

Pyetja 6

Dy rezistenca të barabarta R janë lidhur në seri dhe të dyja bashkë lidhen në paralel me një rezistencë tjetër R. Sa do të jetë rezistenca e njëvlershme?

- A) $R/2$
- B) R
- C) $3R/2$
- D) $2R/3$

Pyetja 7

Dy përcues me rezistenca R_1 e R_2 janë lidhur në seri dhe në to kalon rryma I . Duke shënuar me U_1 dhe U_2 , diferencat e potencialeve në skajet e tyre, mund të themi se:

- A) $U_1=U_2$
- B) $U_1R^2_2= U_2R^2_1$
- C) $U_1R_1= U_2R_2$
- D) $U_1/R_1= U_2/R_2$

Pyetja 8

Tri llamba me fuqi përkatësisht: $P_1=20W$, $P_2=60W$ dhe $P_3=100W$, ushqehen nga një rrymë me tension $220V$. Cili relacion jep saktë lidhjen midis rezistencave?

- A) $R_1<R_2<R_3$
- B) $R_1>R_2>R_3$
- C) $R_1=R_2=R_3$
- D) $R_1<R_2=R_3$

Pyetja 9

Një pajisje elektrike transformon 75% të energjisë së saj në nxehtësi, 20% në energji kinetike dhe 5% në energji të zërit. Cila është kjo pajisje?

- A) hekur për hekurosje
- B) altoparlant
- C) tharëse flokësh
- D) ngrohës elektrik

Pyetja 10


Për të ngarkuar baterinë e një telefoni, nevojitet një rrymë $300mA$. Sa ngarkesë kalon nëpër qark nëse karikojmë baterinë për dy orë?

- A) $0.6C$
- B) $150C$
- C) $600C$
- D) $2160C$

Pyetja 11

Rryma rrjedh në dy rezistenca të lidhura në seri. A_1 dhe A_2 janë leximet e ampermetrave dhe U_1 e U_2 janë leximet e voltmetrave. Cila nga alternativat e mëposhtme përshkruan leximin e ampermetrave dhe voltmetrave?


- A) $I_1=I_2$ $U_1=U_2$
- B) $I_1=I_2$ $U_1<U_2$
- C) $I_1>I_2$ $U_1=U_2$
- D) $I_1<I_2$ $U_1<U_2$



Pyetja 12

Cili kombinim i rezistencave identike ka vlerë të rezistencës së njëvlershme më të vogël?


- A) Kombinimi A
- B) Kombinimi B
- C) Kombinimi C
- D) Kombinimi D



Pyetja 13

Katër llamba identike janë të lidhura si në figurë. Cili nga pohimet e mëposhtme është i saktë?

- A) Llamba P ndriçon njësoj si llamba Q.
- B) Llamba P ndriçon njësoj si llamba S.
- C) Llamba Q ndriçon më shumë se llamba S.
- D) Llamba R ndriçon më shumë se llamba P.



Pyetja 14

Në një ngrohës me tension 240V kalon rryma 4A. Sa energji transferohet në ngrohës në 5 minuta?

- A) 192J
- B) 4800J
- C) 18000J
- D) 288000J

Pyetja 15

Filamenti prej tungsteni i një llambe inkandeshente, merr vazhdimisht nxehtësi gjatë kohës që ajo rri ndezur. Filamenti nuk shkrin sepse:

- A) nxehtësia përhapet në formën e rrezatimit.
- B) llamba është e mbushur me një gaz me përçueshmëri të lartë termike.
- C) filamentin, ka një temperaturë shkrirje të ulët.
- D) filamentin ka rezistencë elektrike të ulët.

Pyetja 16


Tek etiketa e një thekëse buke, lexojmë: tensioni 220V, fuqia 2000W. Rezistenca e elementëve ngrohës do të ketë një vlerë afërsisht:

- A) 0.11Ω
- B) 4.4Ω
- C) 9.1Ω
- D) 24.2Ω

Pyetja 17

Në qarkun e paraqitur më poshtë rrjedh rryma I. Raporti i fuqive P_1/P_2 është:


- A) 0.25
- B) 0.5
- C) 2
- D) 4



Pyetja 18

Grafiku i mëposhtëm tregon varësinë e intensitetit të rrymës nga tensioni për katër përçues të ndryshëm A, B, C dhe D. Cili është përcjellës më i mirë?


- A) Përçuesi A
- B) Përçuesi B
- C) Përçuesi C
- D) Përçuesi D



Pyetja 19

Në një qark janë lidhur tri dioda dhe tri rezistenca si në figurë. Kur mbyllim çelësin K, rryma kalon në degët:

- A) 1; 2; 3
- B) 1; 3
- C) 1; 2
- D) 2; 3



Pyetja 20

Një furnelë elektrike përbëhet nga një tel përçues në formë spire, i cili skuqet kur në të kalon rrymë elektrike. Një pjesë e kësaj spire duket më e skuqur se pjesa tjetër. Kjo ndodh sepse në këtë pjesë të spirës:

- A) intensiteti i rrymës që rrjedh në të është më i vogël.
- B) intensiteti i rrymës që rrjedh në të është më i madh.
- C) rezistenca e rrymës më e vogël.
- D) trashësia e telit është më e vogël.

Pyetja 21

Në një rezistencë me vlerë 4Ω zbatohet tensioni $16V$. Nëse përgjysmojmë vlerën e rezistencës për të mbajtur konstante rrymën që kalon në të, duhet të zbatojmë një tension me vlerë:

- A) $2V$
- B) $4V$
- C) $8V$
- D) $32V$

Pyetja 22

Rezistenca e një llambe inkandeshente A është më e vogël se rezistenca e një llambe inkandeshente B. Për tension të njëjtë të aplikuar në secilën nga llambat, cila prej tyre do të ndriçojë më shumë?

- A) Llamba A.
- B) Llamba B.
- C) Llambat ndriçojnë njësoj.
- D) Varet nga lënda nga e cila përbëhen llambat.

Pyetja 23

Në një llambë me rezistencë R , rrjedh rryma me intensitet I . Çfarë rezistence duhet të lidhet në paralel me të, në mënyrë që intensiteti i rrymës të bëhet $2I$?

- A) R
- B) $R/2$
- C) $2R$
- D) $4R$

Pyetja 24

Nëse përgjysmojmë diferencën potenciale në skajet e një përçuesi omik, fuqia në të:

- A) rritet 4 herë.
- B) zvogëlohet 4 herë.
- C) rritet 2 herë.
- D) nuk ndryshon.

Pyetja 25

Duke lidhur në paralel dy rezistenca R_1 dhe R_2 të tilla që $R_1 < R_2$, rezistenca ekuivalente është:

- A) R_e më e madhe se R_2 .
- B) R_e më e madhe se R_1 dhe më e vogël se R_2 .
- C) Nuk mund ta përcaktojmë pasi nuk njohim vlerat e R_1 dhe R_2 .
- D) R_e më e vogël se R_1 .

Pyetja 26


Një llambë inkandeshente $120W$ dhe një ngrohës elektrik $1500W$ ushqehen me të njëjtin tension. Mund të themi se:

- A) rezistencat elektrike të dy pajisjeve janë të njëjta.
- B) rezistenca e ngrohësit elektrik është më e madhe.
- C) rezistenca e llambës inkandeshente është më e madhe.
- D) nuk mund të përgjigjemi, sepse nuk njohim intensitetin e rrymës.

Pyetja 27

Figura e mëposhtme paraqet një bateri $6V$ të lidhur me dy rezistenca. Cila nga alternativat tregon sakte rrymat përkatëse në ampermetra?


- A) $1A$; $1A$; $2A$
- B) $1A$; $2A$; $1A$
- C) $3A$; $2A$; $1A$
- D) $3A$; $1A$; $2A$



Pyetja 28

Një bateri 5V është e lidhur me dy rezistenca të njëjta dhe një llambë si në figurë. Nëse diferenca e potencialit në skajet e llambës është 1V, cila është diferenca potenciale në skajet e secilës rezistencë?

- A) 2V
- B) 4V
- C) 5V
- D) 6V



Pyetja 29

Një burim rryme i vazhduar është i lidhur me një rezistencë nëpër të cilën kalon rryma I. Dy rezistenca të tjera të njëjta me të parën, lidhen në seri me të. Sa do të bëhet vlera e rrymës?

- A) 0.25I
- B) 0.33I
- C) I
- D) 3I

Pyetja 30

Kemi një burim rryme dhe tri llamba A, B dhe C. Si duhet t'i lidhim llambat, në mënyrë të tillë që llamba A të ndizet pavarësisht nga B dhe C, të cilat mund të ndizen dhe fiken vetëm njëkohësisht?

- A) Të tri llambat duhet t'i lidhim në paralel.
- B) Llambat B dhe C i lidhim në paralel dhe të dyja bashkë i lidhim në seri me A.
- C) Të tri llambat i lidhim në seri.
- D) Llambat B dhe C në seri dhe të dyja bashkë në paralel me A.

Pyetja 31

Një pjesë qarku elektrik ka rezistencë R. Nëse duam të përgjysojmë vlerën e rezistencës në R/2, nevojitet që të shtojmë në qark një rezistencë të dytë:

- A) me vlerë R në paralel
- B) me vlerë R/2 në paralel
- C) me vlerë R në seri
- D) me vlerë 2R në seri

Pyetja 32

Filamenti i një llambe përshkohet nga një rrymë me intensitet 1.6A. Sa elektrone në sekondë përshkohnë prerjen tërthore të përçuesit? ($q_e=1.610^{-19}C$)

- A) 10^{-19} elektrone
- B) 1 elektron
- C) 10^3 elektrone
- D) 10^{19} elektrone

Pyetja 33

Në një furnelë me rezistencë R dhe tension U, duhet të vlojmë një litër ujë. Koha e nevojshme për vlimin e ujit është proporcionale me:

- A) U^2
- B) R
- C) U
- D) R^2

Pyetja 34

Një qark elektrik përbëhet nga një bateri me f.e.m ϵ dhe dy rezistenca të njëjta R, të cilat mund të lidhen në seri ose në paralel. Rryma që kalon në qark është:

- A) e njëjtë në të dyja rastet.
- B) zero, nëse lidhen në seri.
- C) më e madhe nëse rezistencat lidhen në paralel.
- D) më e madhe nëse rezistencat lidhen në seri.

Pyetja 35

Bateria 3V e një makine llogaritëse jep një rrymë 0.17mA. Sa ngarkesë kalon në qark gjatë një ore pune të makinës llogaritëse?

- A) 0.17C
- B) 0.612C
- C) 612C
- D) 0.021C

Pyetja 36

Për të ruajtur instalimet elektrike nga kalimi i një rryme me intensitet të lartë përdorim:

- A) voltmetër
- B) siguresë
- C) galvanometër
- D) rezistencë

Pyetja 37

Një zog mund të qëndrojë mbi një linjë të transmetimit të tensionit të lartë pa u goditur nga rryma. Cila nga pohimet shpjegon saktë situatën?

- A) Të dyja këmbët e zogut janë në të njëjtin potencial.
- B) Trupi i zogut ka rezistencë shumë të lartë.
- C) Trupi i zogut ka rezistencë shumë të ulët.
- D) Ajri midis puplave shërben si izolues.

Pyetja 38

Cili nga pohimet për tokëzuesin është i saktë, kur lidhim një makinë larëse në rrjet?

- A) Tokëzuesi ka potencial të lartë prandaj është e rrezikshme të prekim makinën larëse.
- B) Tokëzuesi duhet të lidhet me pjesën e jashtme të makinës larëse.
- C) Tokëzuesi nuk mbart asnjë ngarkesë prandaj është i sigurt nëse e prekim atë.
- D) Nëse shkëpusim tokëzuesin, makina vazhdon të punojë.

Pyetja 39


Një rrymë konstante me intensitet 2A, rrjedh në një pajisje elektrike. Për sa kohë kalojnë $4.5 \cdot 10^{22}$ elektrone?

- A) 7200s
- B) 5400s
- C) 3600s
- D) 1800s

Pyetja 40

Grafiku i mëposhtëm tregon varësinë e intensitetit të rrymës nga tensioni për katër përçues të ndryshëm A, B, C dhe D. Cili nga përçuesit ka rezistencë më të madhe kur në skajet e tyre zbatohet tension i njëjtë?

- A) Përçuesi A
- B) Përçuesi B
- C) Përçuesi C
- D) Përçuesi D



Pyetja 41

Dy shufra bakri me gjatësi të njëjtë dhe prerje tërthore që rrinë si $S_1:S_2=1:2$ e kanë raportin e vlerave të rezistencave:

- A) $\frac{R_1}{R_2}=2$
- B) $\frac{R_1}{R_2}=1$
- C) $\frac{R_1}{R_2}=1/2$
- D) $\frac{R_1}{R_2}=1/4$

Pyetja 42

Një tel përcjellës prej bakri e ka gjatësinë l dhe rezistencën R . Rezistenca e këtij teli bakri me gjatësi $4l$ do të jetë:

- A) R
- B) $2R$
- C) $3R$
- D) $4R$

Pyetja 43

Një përcjellës me gjatësi $0,5\text{m}$ e ka rezistencën elektrike R . Përcjellësi ndahet në dy pjesë me gjatësi $0,25\text{m}$, të cilat duke u përdredhur në gjithë gjatësinë e tyre, do të kenë vlerën e rezistencës:

- A) R
- B) $\frac{R}{2}$
- C) $\frac{R}{4}$
- D) $\frac{R}{16}$

Pyetja 44

Një tel bakri me gjatësi 2 m dhe sipërfaqe të prerjes tërthore 1 cm^2 , e ka rezistencën specifike $1,7 \cdot 10^{-8} \Omega\text{m}$. Rezistenca e tij është:

- A) $6,8 \cdot 10^{-3} \Omega$
- B) $3,4 \cdot 10^{-4} \Omega$
- C) $1,7 \cdot 10^{-4} \Omega$
- D) $0,8 \cdot 10^{-4} \Omega$

Pyetja 45

Dy tela prej alumini kanë gjatësi dhe prerje tërthore të njëjtë. Teli i parë ndodhet në temperaturën 20°C . Teli i dytë ndodhet në temperatura 80°C . Rezistenca e telit të dytë:

- A) është më e madhe se rezistenca e të parit.
- B) është më e vogël se rezistenca e të parit.
- C) është e njëjtë me rezistencën e të parit.
- D) Varet nga mënyra e lidhjes në qarkun elektrik.

Pyetja 46

Cili nga pohimet e mëposhtme është i vërtetë?

- A) Rezistenca e një përcjellësi nuk varet nga ndryshimet e temperaturës së tij.
- B) Rezistenca e përcjellësit i detyrohet vetëm ndryshimit të rezistencës specifike.
- C) Për përcjellësit metalik, rezistenca rritet me rritjen e temperaturës.
- D) Për përcjellësit metalik, rezistenca zvogëlohet me rritjen e temperaturës.

Pyetja 47

Dy tela përcjellës kanë sipërfaqe të prerjes tërthore të njëjtë dhe gjatësi $l_2=4l_1$ dhe rezistenca specifike $\rho_1=2\rho_2$. Lidhja e rezistencave të tyre është:

- A) $2R_1=R_2$
- B) $4R_1=R_2$
- C) $R_1=2R_2$
- D) $R_1=4R_2$

Pyetja 48

Kuptimi i rezistencës elektrike është i lidhur me:

- A) vështirësinë që hasin elektronet për t'u orientuar në këtë përcjellës, kur ai është në një fushe elektrike.
- B) lehtësinë që kanë elektronet për t'u orientuar në këtë përcjellës, kur ai është në një fushe elektrike.
- C) numrin e elektroneve të lira të orientuara në këtë përcjellës në prani të një fushe elektrike.
- D) tensionin në skajet e rezistencës dhe me rrymën që kalon në përcjellës.

Pyetja 49

Cili nga pohimet e mëposhtëm është i vërtetë?

- A) Rezistenca e një teli përcjellësi është në përpjesëtim të drejtë me gjatësinë dhe sipërfaqen e prerjes tërthore të përcjellësit.
- B) Rezistenca e një teli është në përpjesëtim të drejtë me gjatësinë dhe në përpjesëtim të zhdrejtë me sipërfaqen e prerjes tërthore të përcjellësit.
- C) Rezistenca e një teli është në përpjesëtim të drejtë me gjatësinë dhe në përpjesëtim të zhdrejtë me rezistencën specifike të përcjellësit.
- D) Rezistenca e një përcjellësi nuk varet nga lloji i materialit, por vetëm nga gjatësia dhe sipërfaqja e prerjes tërthore të përcjellësit.

Pyetja 50


Dy tela përcjellës A dhe B kanë gjatësi dhe sipërfaqe të prerjes tërthore të njëjtë, por teli B e ka rezistencën specifike dy herë më të madhe se teli A. Lidhja midis këtyre rezistencave është:

- A) $R_A=R_B$
- B) $R_A=2 \cdot R_B$
- C) $R_B=2 \cdot R_A$
- D) $R_B=\sqrt{2}R_A$

Pyetja 51

Në figurë jepet varësia e rrymës nga tensioni për filamentin e tungstenit për temperatura të ndryshme. Cili pohim është i vërtetë?

- A) Intensiteti i rrymës është në përpjesëtim të drejtë me tensionin.
- B) Rezistenca e filamentit ka vlerë të pandryshuar.
- C) Rezistenca e tungstenit rritet me rritjen e temperaturës.
- D) Rezistenca e tungstenit zvogëlohet me rritjen e temperaturës.



Pyetja 52

Rezistenca e një teli është 3Ω . Rezistenca specifike është $1,8 \cdot 10^{-8}\Omega\text{m}$ dhe sipërfaqja e prerjes tërthore $1,2\text{mm}^2$. Gjatësia e telit është:

- A) 150m
- B) 200m
- C) 250m
- D) 300m

Pyetja 53

Çmimi i 1kWh energjie elektrike është 30 lekë. Po të mbajmë ndezur një llambë 100W nga ora 8 e mëngjesit deri në orën 8 të mëngjesit tjetër do të na kushtojë:

- A) 30 lekë
- B) 36 lekë
- C) 72 lekë
- D) 360 lekë

Pyetja 54

Një hekur për hekurosje, i cili ushqehet me tension 220V, përthith energjinë 0.55kWh në 30min. Rryma që kalon në të është:

- A) 0.083A
- B) 1.25A
- C) 5A
- D) 300A

Pyetja 55

Në matësin e energjisë elektrike shënohet: tensioni i linjës 220V dhe intensiteti maksimal i lejuar i rrymës 10A. A mund ta shfrytëzojmë këtë linjë për të përdorur njëkohësisht një bolier me fuqi 1.5kW, një hekur për hekurosje me fuqi 0.3kW, dy llamba me fuqi 50W secila dhe një llambe me fuqi 40W?

- A) Po
- B) Jo
- C) Po, nëse fikim hekurin
- D) Po, por duhet të përdorim maksimumin e rrymës së lejuar.

Pyetja 56


Për të ndezur një makinë, përdoret një bateri 45Ah (amper ore). Motorino funksionon për 3s dhe rryma që ai përthith është 250A. Me sa zvogëlohet ngarkesa e baterisë?

- A) Afërsisht 0.5%
- B) Afërsisht 5%
- C) Afërsisht 10%
- D) Afërsisht 50%

Pyetja 57

Qarku paraqet rezistenca të njëjta të lidhura me një burim rryme. Cili nga pohimet e mëposhtme është i saktë?

- A) $I=I_1$ dhe $U=U_3$
- B) $I=I_1+I_3$ dhe $U=U_1+U_2$
- C) $I=I_2+I_3+I_4$ dhe $U=U_1+U_2$
- D) $I=I_1+I_2+I_3+I_4$ dhe $U=U_1+U_2+U_3+U_4$



Pyetja 58

Dy rezistenca me vlera përkatësisht R dhe 2R, janë lidhur në seri. Ç'vlerë duhet të kenë dy rezistenca të njëjta, të cilat, duke u lidhur në paralel, të kenë një rezistencë të njëvlershme të barabartë me rezistencën e njëvlershme të dy rezistencave R dhe 2R të lidhura në seri?

- A) R/6
- B) R/3
- C) 3R/3
- D) 6R

Pyetja 59

Një muskul, me rezistencë 40Ω, duhet të përshkohet nga një rrymë me intensitet 100mA. Duke përdorur një gjenerator me tension 20V, nevojitet të lidhim me të:

- A) një rezistencë 160Ω, në seri.
- B) një rezistencë 10Ω në paralel.
- C) një rezistencë 40Ω në seri.
- D) një rezistencë 40Ω në paralel.

Pyetja 60

Diferenca potenciale midis dy pikave X dhe Y në një qark elektrik është 18V. Rryma që kalon në të është 1.5A dhe koha që duhet për të mbartur ngarkesën nga X në Y është 0.2s. Sa është ndryshimi i energjisë së lëvizjes së ngarkesës kur ajo kalon nga X në Y?

- A) 0.017J
- B) 5.4J
- C) 60J
- D) 135J

Pyetja 61

Një pilë me f.e.m $1.5V$ kur lidhet me një rezistencë 14Ω , prodhon një tension $1.4V$ në skajet e rezistencës. Rezistenca e brendshme e pilës duhet të jetë:

- A) 1Ω
- B) 14Ω
- C) 15Ω
- D) 21Ω

Pyetja 62

Ç' sasi ngarkese kalon në një pike të përçuesit, nëse nëpër këtë pikë rrjedh rryma $60mA$ në 10 minuta?

- A) $0.0001C$
- B) $6C$
- C) $36C$
- D) $600C$

Pyetja 63

Katër ngrohës elektrik lidhen në paralel me të njëjtin burim rryme. Rezistenca e katër ngrohëseve dhe koha e përdorimit të tyre tregohet më poshtë. Cili nga ngrohësit konsumon më pak energji elektrike?

- A) $R=17\Omega$ $t=255s$
- B) $R=18\Omega$ $t=234s$
- C) $R=19\Omega$ $t=380s$
- D) $R=20\Omega$ $t=400s$

Pyetja 64


Një fshesë me korrent $1.9kW$ dhe një televizor $200W$, janë lidhur në paralel me një burim $220V$. Çfarë siguresë duhet të lidhim në rrjet?

- A) $7A$
- B) $8A$
- C) $9A$
- D) $10A$

Pyetja 65

Dy përçues elektrik me rezistenca përkatësisht $1M\Omega$ dhe $200K\Omega$, janë lidhur si në figurë. Pika P është e tokëzuar dhe potenciali në Y është $3V$. Sa është potenciali në X?


- A) $15V$
- B) $12V$
- C) $-12V$
- D) $-15V$



Pyetja 66

Figura e mëposhtme tregon katër llamba identike A, B, C dhe D të lidhura në një qark të mbyllur. Cila nga llambat do të ndriçojë më shumë?

- A) Llamba A
- B) Llamba B
- C) Llamba C
- D) Llamba D



Pyetja 67

Kur katër rezistenca identike lidhen si në figurën 1, ampermetri tregon vlerën $1A$ dhe voltmetri vlerën zero. Nëse elementët i lidhim si në figurën 2, ç'vlera do të tregojë voltmetri dhe ampermetri?

- A) $0V$ $1A$
- B) $0V$ $0.5A$
- C) $3V$ $1A$
- D) $6V$ $0.5A$




Figura 1





Figura 2

Pyetja 68

Figura paraqet një qark të thjeshtë me tri rezistenca të lidhura me një bateri me f.e.m. Vlera e rezistencës P është sa $\frac{1}{2}$ e rezistencës Q. Intensiteti i rrymës që kalon në Q është 0.4A. Sa është diferenca potenciale në skajet e rezistencës P?


- A) $\frac{1}{2}(\varepsilon-1.8)V$
- B) $\frac{1}{3}(\varepsilon-3.6)V$
- C) $(\varepsilon-1.8)V$
- D) $(\varepsilon-3.6)V$



Pyetja 69

Figura tregon një pjesë të një qarku. Sa është vlera e rrymës që kalon në rezistencën 20Ω ?


- A) 0.5A
- B) 1A
- C) 4A
- D) 6A



Pyetja 70

Katër rezistenca janë lidhur me një bateri si në figurë. Ç'vlerë do të tregojë ampermetri?

- A) 1A
- B) 3A
- C) 4A
- D) 12A



Pyetja 71

Sa do të jetë f.e.m e një pile, nëse ajo përdor 1kJ energji për të dërguar një rrymë me vlerë 3A nëpër qark për 2 minuta?

- A) 2.8V
- B) 6V
- C) 25V
- D) 360V

Pyetja 72


Një rezistencë ushqehet me tension U dhe përshkohet nga rryma me intensitet I. Shënojmë me q ngarkesën që kalon nëpër rezistencë gjatë një ore, me E energjinë e përçuar në një orë dhe me P fuqinë. Në cilën nga alternativat e mëposhtme shprehet saktë lidhja midis madhësive të mësipërme?

- A) $I=3600q$; $E=3600UI$; $P=UI$
- B) $q=3600I$; $E=3600UI$; $P=UI$
- C) $q=3600I$; $E=UI$; $P=3600UI$
- D) $I=3600q$; $E=UI$; $P=(1/3600)UI$

Pyetja 73

Në qark janë lidhur tri llamba identike, një burim rryme dhe një rezistencë me vlerë të ndryshueshme. Bateria ka një f.e.m 3V. Kur rezistenca vendoset në vlerën 0Ω , rryma që kalon në bateri ka vlerën 0.5A. Sa është rezistenca në secilën llambë?

- A) 2Ω
- B) 4Ω
- C) 6Ω
- D) 18Ω



Pyetja 74

Një sistem ndriçues përbëhet nga 10 llamba me ndriçim normal. Pesë prej tyre kanë vlerat 230V dhe 100W, pesë të tjerat 230V dhe 120W. Sa është vlera e siguresës që duhet të lidhim në sistem për mbrojtjen e llambave?

- A) 1.09A
- B) 3.64A
- C) 4.8A
- D) 10.2A

Pyetja 75

Një sistem ndriçues përbëhet nga 10 llamba me ndriçim normal. Pesë prej tyre kanë vlerat 230V dhe 100W, pesë të tjerat 230V dhe 120W. Nëse sistemi ndriçues mbahet ndezur për një javë, sa lekë do të kushtojë energjia e harxhuar, nëse 1KWh kushton 20 lekë?

- A) 1680 lekë
- B) 2016 lekë
- C) 3696 lekë
- D) 7392 lekë

Pyetja 76

Qarku elektrik përbëhet nga një bateri 10V dhe dy rezistenca R_1 dhe R_2 të lidhura në seri. Sa do të jetë vlera e R_1 , nëse fuqia e plotë është 50W dhe $R_2=3R_1$?

- A) 0.5Ω
- B) 1Ω
- C) 1.2Ω
- D) 5Ω

Pyetja 77


Energjia e përftuar nga një panel diellor përdoret për të ngarkuar një bateri. Gjatë ditës bateria ruan 1.6J energji çdo sekondë. Natën, bateria përdoret për të ndriçuar një llambë me fuqi 1.2W për 18000s. Sa është koha minimale që duhet për të ngarkuar baterinë gjatë ditës?

- A) 9375s
- B) 13500s
- C) 24000s
- D) 34560s

Pyetja 78

Në cilin nga qarqet e mëposhtme voltmetri tregon vlerën 7.2V?


- A) Qarku A
- B) Qarku B
- C) Qarku C
- D) Qarku D



Pyetja 79

Një burim rryme 1.8V lidhet me një qark elektrik me tri rezistenca me vlerë 6Ω secila. Sa është puna e kryer nga bateria në 1 minutë?

- A) 18J
- B) 48.6J
- C) 108J
- D) 778J



Pyetja 80

Një tel përçues i lidhur me një burim rryme me tension 230V ka fuqi P_1 . Nëse telin e ndajmë në dy pjesë të barabarta dhe i lidhim në paralel me të njëjtin burim rryme, ai do të ketë fuqi P_2 . Raporti i fuqive P_2/P_1 është:

- A) 1
- B) 2
- C) 3
- D) 4

Pyetja 81


Defibrilatori është pajisje që përdoret për t'i dhënë një goditje elektrike zemrës së pacientit. Ai përdor një goditje elektrike me energji 300J dhe një tension mesatar 2000V për 10ms. Sa është vlera mesatare e rrymës që furnizon qarkun?

- A) 0.015A
- B) 0.67A
- C) 6.7A
- D) 15A

Pyetja 82

Diagrami i qarkut tregon tre rezistenca R_1 , R_2 dhe R_3 të lidhur me një burim rryme. Në secilën rezistencë kalojnë përkatësisht rrymat I_1 , I_2 dhe I_3 . Cila nga shprehjet e mëposhtme paraqet saktë raportin $\frac{R_2}{R_3}$?

- A) $\frac{I_2}{I_3}$
- B) $\frac{I_1 - I_3}{I_3}$
- C) $\frac{I_1 - I_2}{I_2}$
- D) $1 + \frac{I_3}{I_2}$



Pyetja 83

Rryma me intensitet 3A kalon nëpër një qark elektrik për 5 minuta duke kryer një punë 900J. Sa është f.e.m. e burimit?

- A) 1V
- B) 3V
- C) 5V
- D) 10V

Pyetja 84


Përdorimi i cilës nga pajisjeve të mëposhtme do të na kushtojë më pak? (Çmimi për 1kWh është 20 lekë)

- A) Kompjuter (fuqia 1500W, koha e përdorimit 8 orë)
- B) Ndriçues tavoline (fuqia 800W, koha e përdorimit 18 orë)
- C) Drita (fuqia 3000W, koha e përdorimit 3 orë)
- D) Ngrohës uji (fuqia 2500W, koha e përdorimit 6 orë)

Pyetja 85

Në qarkun e treguar ampermetri shënon vlerën 2A. Sa do të jetë vlera që tregon voltmetri?

- A) 4V
- B) 6V
- C) 8V
- D) 12V



Pyetja 86

Diferenca e potencialit në skajet e një rezistence 10Ω është $5V$. Ç'ngarkesë kalon në rezistencë në $30s$?

- A) $2C$
- B) $15C$
- C) $60C$
- D) $1500C$

Pyetja 87


Një akumulator, furnizon me ngarkesë $9600C$, një përçues me rezistencë 18Ω në $7200s$. Sa është puna e kryer për të lëvizur ngarkesën $1C$ nëpër përçues?

- A) $12J$
- B) $21.5J$
- C) $24J$
- D) $32J$

Pyetja 88

Dy rezistenca 6Ω dhe 12Ω janë lidhur në paralel. Midis pikave X dhe Y zbatohet një diferencë potenciali. Rryma në rezistencën 6Ω është $4A$. Sa është vlera e rrymës që tregon ampermetri?

- A) $4A$
- B) $6A$
- C) $8A$
- D) $12A$



Pyetja 89

Në një qark me bateri me f.e.m $6V$, kalojnë $10C$ ngarkesa për $15s$. Sa është fuqia në qark?

- A) $4W$
- B) $24W$
- C) $60W$
- D) $240W$

Pyetja 90

Një kilowat-orë energji elektrike shpenzohet kur:

- A) një llambë $50W$ përdoret për 220 orë.
- B) një ngrohës $3000W$ përdoret për 20 minuta.
- C) një llambë $100W$ përdoret për 1 orë.
- D) dy llamba nga $100W$ të lidhura në paralel përdoren për $1/2$ orë.

Pyetja 91

Një burim rryme me rezistencë të brendshme r përdoret për të vënë në punë një llambë me rezistencë R . Ç pjesë e fuqisë totale i jepet llambës?

- A) $\frac{R+r}{R}$
- B) $\frac{R-r}{R}$
- C) $\frac{R}{R+r}$
- D) $\frac{R}{r}$

Pyetja 92

Një burim me f.e.m. $24V$ dhe rezistencë të brendshme r është lidhur me një rezistencë 11Ω . Rënia e tensionit në skajet e rezistencës është $22V$. Rezistenca e brendshme është:

- A) 0.5Ω
- B) 0.75Ω
- C) 1Ω
- D) 1.25Ω

Pyetja 93

Dy tela përcjellës prej bakri kanë gjatësi të njëjtë. I pari është një shufër e plotë dhe i dyti është në formë tubi me diametër të njëjtë me të parin. Cili nga pohimet e mëposhtëm është i saktë?

- A) Teli përcjellës në formë shufre të plotë, ka rezistencë më të madhe.
- B) Teli përcjellës në formë tubi ka rezistencë më të madhe.
- C) Rezistencat e tyre kanë vlerë të njëjtë.
- D) Rezistencat e tyre nuk mund t'i krahasojmë.

Pyetja 94

Dy përcjellësa A dhe B përbëhen prej të njëjtit material. Përcjellësi A është 4 herë më i gjatë se përcjellësi B. Përcjellësi B e ka sipërfaqen e prerjes tërthore 2 herë më të madhe se përcjellësi A. Raporti i rezistencave të përcjellësit B ndaj A është:

- A) $\frac{1}{8}$
- B) $\frac{1}{4}$
- C) $\frac{1}{2}$
- D) 1

Pyetja 95

Gjatë procesit të telëzimit, një tel përcjellës me gjatësi 1m, prej bakri u bë 8 herë më i gjatë dhe diametri i tij prej 2cm u zvogëlua me 2 herë. Rezistenca e tij pas procesit të telëzimit u rit:

- A) 4 herë
- B) 8 herë
- C) 16 herë
- D) 32 herë

Pyetja 96

Përcjellësi me gjatësi 4m dhe diametër 6mm, e ka rezistencën $15\text{m}\Omega$. Rezistenca specifike e tij është: ($\pi=3.14$)

- A) $10,6 \cdot 10^{-8} \Omega \cdot \text{m}$
- B) $18,6 \cdot 10^{-8} \Omega \cdot \text{m}$
- C) $24,6 \cdot 10^{-8} \Omega \cdot \text{m}$
- D) $32,6 \cdot 10^{-8} \Omega \cdot \text{m}$

Pyetja 97

Dy përcjellësa cilindrik A dhe B kanë gjatësi të njëjtë dhe janë prej të njëjtit material. Rezistenca e A është 4 herë më e madhe se e B. Diametri i përcjellësit B në krahasim me atë të përcjellësit A do të jetë:

- A) $\sqrt{2}$ herë më i vogël
- B) 2 herë më i vogël
- C) $\sqrt{2}$ herë më i madh
- D) 2 herë më i madh

Pyetja 98

Tri tela përcjellës i kanë rezistencat e tyre R_1 , R_2 dhe R_3 . Teli i dytë dhe i tretë e kanë rezistencën specifike 2 herë më të madhe se i pari. Teli i dytë ka gjatësinë sa i pari dhe diametrin $\sqrt{2}$ herë më të madhe se i pari. Teli i tretë e ka edhe gjatësinë edhe diametrin 2 herë më të madh se i pari. Lidhja e rezistencave të tyre është:

- A) $R_1 < R_2 = R_3$
- B) $R_1 = R_2 < R_3$
- C) $R_1 = R_2 = R_3$
- D) $R_1 = R_2 > R_3$

Pyetja 99

Ndërmarrja elektrike vendos një tel prej bakri, me gjatësi 100m, nga stacioni i rrugës deri te banesa e konsumatorit. Dimë që rezistenca e telit është $0,6\Omega$ për 300m. Pas një kohe pune, rezistenca e telit u ngroh dhe u rrit me 10% e vlerës fillestare. Vlera e rezistencës pas ngrohjes është:

- A) $0,22\Omega$
- B) $0,33\Omega$
- C) $0,44\Omega$
- D) $0,55\Omega$

Pyetja 100

Në një qark elektrik rezistenca doli jashtë përdorimit dhe duhet zëvendësuar me një rezistencë me vlerë të njëjtë. Rezistenca zëvendësuese e ka rezistencën specifike 1,5 herë më të madhe se e të parës dhe gjatësinë 3 herë më të madhe. Sa do të jetë vlera e sipërfaqes së prerjes tërthore të kësaj rezistence në lidhje me të parën, në mënyrë që të mos sjellë ndryshime në qark?

- A) $S_2=S_1$
- B) $S_2=2\cdot S_1$
- C) $S_2=4,5\cdot S_1$
- D) $S_2=6\cdot S_1$

Pyetja 101

Dy shufra përcjellëse prej bakri kanë gjatësi që rrinë si $l_1:l_2=1:4$ dhe diametra $D_1:D_2=1:2$. Raporti i rezistencave të tyre është:

- A) 1
- B) 2
- C) 8
- D) 16

Pyetja 102

Rezistenca e një furnele elektrike është 30Ω . Si rezultat i një defekti u shkurtua me $\frac{1}{10}$ e gjatësisë së saj. Rezistenca e pjesës së mbetur është:

- A) 33Ω
- B) 30Ω
- C) 27Ω
- D) 24Ω

Pyetja 103

Teli përcjellës me rezistencë 40Ω si rezultat i punës për një kohë të gjatë, e rriti gjatësinë e tij me 20%, diametrin e rriti me 4% dhe rezistencën specifike e rriti me 10%. Vlera e rezistencës së tij në këtë regjim pune është:

- A) $42,2\Omega$
- B) $44,4\Omega$
- C) $46,6\Omega$
- D) $48,8\Omega$

Pyetja 104


Një tel përcjellës cilindrik e ka gjatësinë 50m, rezistencën $2,5\Omega$ dhe rezistencën specifike $1,5\cdot 10^{-6}\Omega\text{m}$. Rrezja e telit është: ($\pi=3.14$)

- A) 0,1mm
- B) 1,1mm
- C) 2,1mm
- D) 3,1mm

Pyetja 105

Një qark përbëhet nga dy bateri, dy rezistenca dhe tre ampermetra të lidhura si në figurë. Vlerat e f.e.m. janë përkatësisht 10V dhe 5V. Vlerat që tregojnë ampermetrave në qark janë:


- A) 0.4A; 0.25A; 0.25A
- B) 0.5A; 0.25A; 0.25A
- C) 1A; 0.25A; 0.75A
- D) 1A; 0.5A; 0.5A



Pyetja 106

Në figurë paraqitet skema e një qarku elektrik. Ampermetri tregon vlerën 0.05A. Sa është vlera e rezistencës P?


- A) 50Ω
- B) 100Ω
- C) 150Ω
- D) 300Ω



Pyetja 107

Një bateri me f.e.m ϵ dhe rezistencë të brendshme r , furnizohet me një rrymë me intensitet 0.025A për 80s. Gjatë kësaj kohe ajo prodhon 18J energji elektrike, ndërkohë që rezistenca P merr 11J energji dhe rezistenca Q merr 4J. Cilat janë vlerat për rezistencën e brendshme dhe f.e.m?


- A) 60Ω 360V
- B) 60Ω 9V
- C) 300Ω 9V
- D) 300Ω 360V



Pyetja 108

Një burim me f.e.m 120V dhe rezistencë të brendshme r është lidhur me dy rezistenca R_1 dhe R_2 si në figurë. Vlerat e rrymës në secilën rezistencë janë 1.2A dhe 0.4A. Sa është rezistenca e brendshme e burimit?


- A) 15Ω
- B) 20Ω
- C) 60Ω
- D) 75Ω



Pyetja 109

Një bateri me katër elemente të njëjta me f.e.m 1.5V dhe rezistencë të brendshme $r=0.5\Omega$ secili, janë lidhur me dy rezistenca $R_1=6\Omega$ dhe $R_2=12\Omega$ në një qark elektrik si në figurë. Sa është vlera e rrymës që kalon në qark?


- A) 0.5A
- B) 1A
- C) 1.5A
- D) 2A



Pyetja 110

Figura e mëposhtme paraqet një qark të përbërë nga një bateri me f.e.m \mathcal{E} , tri rezistenca, një voltmetër dhe një ampermetër. Cili nga pohimet e mëposhtme shpreh saktë leximin e ampermetrit dhe voltmetrit?

- A) ampermetri: I_2 ; voltmetri: $I_4R_3+I_3R_2$
- B) ampermetri: I_3+I_4 ; voltmetri: \mathcal{E}
- C) ampermetri: I_1 ; voltmetri: $\mathcal{E}- I_4R_3$
- D) ampermetri: I_1+I_3 ; voltmetri: I_2R_1



Pyetja 111


Kur një rezistencë 4Ω lidhet me një burim rryme, në qark rrjedh rryma me intensitet $2A$. Kur rezistencën e zëvendësojmë me një rezistencë 2Ω , rryma që kalon në qark bëhet $3A$. Cili nga pohimet shpreh saktë vlerat e f.e.m \mathcal{E} dhe rezistencës së brendshme r ?

- A) $\mathcal{E}=15V, r=4\Omega$
- B) $\mathcal{E}=12V, r=2\Omega$
- C) $\mathcal{E}=10V, r=1\Omega$
- D) $\mathcal{E}=8V, r=0\Omega$

Pyetja 112

Figura tregon qarkun e një tharëse flokësh. Motori ka fuqi $0.1kW$ dhe secila nga rezistencat ka fuqi $0.4kW$. Çmimi i energjisë elektrike është 20 lekë për kWh . Sa është vlera e energjisë së harxhuar nga tharësja, nëse ajo punon 2 orë me çelësin P dhe Q të mbyllur dhe çelësin R të hapur?


- A) 10 lekë
- B) 20 lekë
- C) 25 lekë
- D) 30 lekë



Pyetja 113

Në qarqet e mëposhtme, rezistenca P është sa dyfishi i rezistencës Q . Cili nga qarqet ka rezistencën e njëvlershme më të vogël?


- A) Qarku A
- B) Qarku B
- C) Qarku C
- D) Qarku D



Pyetja 114

Figura e mëposhtme tregon skemën e një qarku elektrik ku janë lidhur tri rezistenca. Dy nga rezistencat, të shënuara me R janë të njëjta, rezistenca tjetër ka vlerë 10Ω . Rezistenca e njëvlershme midis Y dhe Z ka vlerën 5Ω . Sa është rezistenca e njëvlershme midis X dhe Z ?

- A) 0.26Ω
- B) 1.9Ω
- C) 2.5Ω
- D) 3.75Ω



Pyetja 115


Dy rezistenca me vlera përkatësisht 2Ω dhe 4Ω janë lidhur në seri me një bateri me tension $6V$. Nxehhtësia e çliruar në rezistencën 4Ω gjatë $5s$ është:

- A) $5J$
- B) $10J$
- C) $20J$
- D) $30J$

Pyetja 116

Në qarkun e dhënë në figurë kalon rryma $3A$ kur çelësi është i hapur. Nëse çelësi mbyllet, rryma në qark bëhet $4A$. F.e.m. dhe rezistenca e brendshme e burimit janë:


- A) $12V; 0.5\Omega$
- B) $18V; 1\Omega$
- C) $24V; 1.5\Omega$
- D) $36V; 2\Omega$



Pyetja 117

Figura tregon një qark që përmban dy burime me f.e.m. me vlera $\mathcal{E}_1=4V, \mathcal{E}_2=2V$ dhe dy rezistenca me vlerë 5Ω dhe 20Ω . Sa do të jetë vlera e intensitetit të rrymës në secilën rezistencë?


- A) 0.1A; 0.3A
- B) 0.3A; 0.4A
- C) 0.4A; 0.1A
- D) 0.8A; 0.4A



Pyetja 118

Figura tregon katër rezistenca të lidhura me një burim rryme të vazhduar 30V. Sa është tensioni në AB?


- A) 12V
- B) 18V
- C) 20V
- D) 30V



Pyetja 119

Tri rezistenca lidhen me një burim rryme të vazhduar me vlerë 3V si në figurë. Cila nga alternativat shpreh saktë vlerat I_1 dhe U_1 ?


- A) $I_1=1.5A$ $U_1=3V$
- B) $I_1=6A$ $U_1=3V$
- C) $I_1=4A$ $U_1=3V$
- D) $I_1=4A$ $U_1=1V$



Pyetja 120

Qarku paraqet lidhjen e katër rezistencave me vlera të ndryshme. Për cilin nga kombinimet e çelësave do të kemi rrymën më të lartë në qark?


- A) P-hapur Q-hapur R-hapur
- B) P-hapur Q-mbyllur R-mbyllur
- C) P-mbyllur Q-hapur R-mbyllur
- D) P-mbyllur Q-mbyllur R-mbyllur



Pyetja 121

Në qark paraqiten tri rezistenca identike. Cila nga alternativat e mëposhtme shpreh saktë raportin e nxehtësisë në rezistencën Q me nxehtësinë në P (Q_Q/Q_P), për të njëjtën kohë pune?

- A) 0.25
- B) 0.5
- C) 2
- D) 4



Pyetja 122

Tri pila të njëjta, secila me një f.e.m 1.5V dhe një rezistencë të brendshme r , janë lidhur në seri me një rezistencë R, fillimisht si në figurën 1 dhe pastaj si në figurën 2. Cili pohim shpreh saktë raportin e fuqive të rezistencës R në figurën 1 dhe figurën 2 (P_1/P_2)?

- A) 3
- B) 5
- C) 7
- D) 9




Fig.1





Fig.2

Pyetja 123

Në qark janë lidhur shtatë rezistenca të njëjta R si në figurë. Rezistenca ekuivalente në daljet X dhe Y është:


- A) $\frac{1}{3}R$
- B) $\frac{2}{3}R$
- C) $\frac{5}{7}R$
- D) $\frac{11}{15}R$



Pyetja 124

Një burim me f.e.m 5V dhe rezistencë të brendshme të papërfillshme është i lidhur me katër rezistenca identike 1Ω dhe një rezistencë tjetër 5Ω , si në figurë. Vlera që tregon voltmetri është:

- A) 0V
- B) 2V
- C) 3V
- D) 5V



Pyetja 125


Dy tela përcjellës në formë cilindrike kanë gjatësi të njëjtë dhe janë prej të njëjtit material. Rezistenca e të parit është 3 herë më e vogël se e të dytit. Diametri i përcjellësit të dytë është:

- A) $D_2 = \frac{D_1}{3}$
- B) $D_2 = \frac{D_1}{\sqrt{3}}$
- C) $D_2 = \sqrt{3} D_1$
- D) $D_2 = 3 D_1$

Pyetja 126

Një copë prej bakri me rezistencë specifike $1,7 \cdot 10^{-8} \Omega m$ lidhet në qark elektrik në tri mënyra. Në figurë janë treguar të tri mënyrat e lidhjes. Vlerat e rezistencave të tyre në këto lidhje janë rrinë si numrat:

- A) 1:2:5
- B) 1:3:6
- C) 1:4:9
- D) 1:6:9



Pyetja 127

Një tel përcjellës prej nikromi me rezistencë specifike $1,2 \cdot 10^{-7} \Omega m$ e ka gjatësinë 1,5m dhe diametrin 0,2mm. Vlerën e rezistencës së tij në duam që ta kemi 30Ω . Sa herë ka ndryshuar gjatësia e tij në krahasim me gjatësinë fillestare për të marr këtë vlerë rezistence? ($\pi=3.14$)

- A) Duhet ta rritim 3,2 herë.
- B) Duhet ta rritim 5,2 herë.
- C) Duhet ta zvogëlojmë me 3,2 herë.
- D) Duhet ta zvogëlojmë me 5,2 herë.

Pyetja 128


Një përcjellës e ka rezistencën 36Ω . Në sa pjesë të barabarta duhet ta ndajmë këtë përcjellës, që duke i përdredhur ato në gjithë gjatësinë e tyre të kemi rezistencën me vlerë 1Ω ?

- A) 36
- B) 18
- C) 6
- D) 3

Pyetja 129

Një copë prej bakri me rezistencë specifike $10^{-6}\Omega\text{m}$ lidhet në qark elektrik si në figurë. Me sa % do të rritim gjatësinë tij, që vlera e rezistencës të jetë $10^{-3}\Omega$:

- A) 25%
- B) 20%
- C) 15%
- D) 10%



Pyetja 130

Një copë prej bakri me rezistencë specifike $10^{-6}\Omega\text{m}$ lidhet në qark elektrik si në figurë. Me sa përqind do të ndryshojë sipërfaqja e prerjes tërthore të tij, që vlera e rezistencës të jetë $10 \cdot 10^{-5}\Omega$?

- A) Zvogëlohet me 30%
- B) Zvogëlohet me 40%
- C) Zvogëlohet me 50%
- D) Zvogëlohet me 60%

